



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Data: 27.11.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për Ri-Shqyrtim të datës; 26.11.2024, të parashtruar nga OE BENI - COM SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Asfaltimi i rruges Marie Shllaku dhe ndërtimi i urës mbi Lumin Sitnica në Rufc të Ri" me nr. të Prokurimit 613-24-9854-5-1-1., Autoriteti kontraktues nxjerr:

V E N D I M

I Refuzohet, kërkesa për ri-shqyrtim, kërkesë e paraqitur më dt; 26.11.2024, nga OE BENI - COM SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:
"Asfaltimi i rruges Marie Shllaku dhe ndërtimi i urës mbi Lumin Sitnica në Rufc të Ri" me nr. të Prokurimit 613-24-9854-5-1-1.

Vërtetohet, Njoftimi mbi Vendimin e AK-së, i publikuara në platformen e prokurimit të datës: 21.11.2024.

1. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të lartëpërmendur.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Autoriteti kontraktues Komuna e Lipjanit ka pranuar kërkesë për Rishqyrtim më dt: 26.11.2024, për aktivitetin e prokurimit me titull "Asfaltimi i rruges Marie Shllaku dhe ndërtimi i urës mbi Lumin Sitnica në Rufc të R" me nr. të Prokurimit 613-24-9854-5-1-1, përmes sistemit elektronik ne E-prokurim.

Pergjigjeja në pretendimin e parë:

1. Sa i përket referencave OE ka përmbushur kërkesat e AK-së sipas DT. Sepse tek Kërkesa 1 është kërkuar qe. Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka perfunduar me sukses kontratat për projekte të ngjashme në vlere prej 750,000.00 Euro per (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, Sqarim OE ka prezantuar dëshmi te mjaftushme per projekte te ngjashme lidhur ne kete AP qe ka te beje me ndertim dhe me infrastrukture. Sqarim: Sikur te ishte ne kerkese ne NJK dhe TD per projekte te njejta do ishte i arsyeshm pretendimi juaj.


Ky pretendim është i pa bazuar.

Drejtori i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lartë, më dt; 27.11.2024, ka vendosur si ne dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.

Bekim Shabani


Drejtör i Prokurimit